

CERTIFIKATA E LEGALIZIMIT

Certifikata e legalizimit lëshohet nga komuna brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas aplikimit.

Certifikata e legalizimit vërteton se prona juaj është e regjistruar në kadastër dhe se ju jeni pronar i ligjshëm i pronës.

SHËNIM:

Disa ndërtime/shtëpi nuk i nënshtrohen legalizimit, nëse:

Ndërtimi/shtëpia juaj tashmë është e regjistruar në Kadastër dhe në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme në komunën tuaj para datës 5 shtator 2018.

Keni filluar të ndërtoni objektin/shtëpinë tuaj pas datës 5 shtator 2018.

Ju mungon vetëm certifikata e shfrytëzimit ose leja e banimit për ndërtimin/shtëpinë tuaj.



NDËRTIMET PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN I NËNSHTROHEN RRËNIMIT.

Për informata të mëtejshme, kontaktoni komunën tuaj ose vizitoni faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në adresën:

<https://bit.ly/3cNeQWy>

Telefoni: +383 38 200 32 053

Telefoni: +383 38 200 32 222

Ligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje mund të gjendet në:

<https://bit.ly/3E9jppqa>

osbe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë




MUNDËSIA E FUNDIT, MOS E HUMB!

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e ka zgatur për herë të fundit afatin për aplikim për legalizim të ndërtimeve pa leje, i cili përfundon më 4 shtator 2022.

LEGALIZO NDËRTIMIN PA LEJE DHE BËHU PRONAR I PRONËS TËNDE

osbe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë



MISIONI I OSBE-SË NË KOSOVË JU INKURAJON QË TA SHFRYTËZONI KËTË MUNDËSI DHE TA LEGALIZONI PRONËN.

LEGALIZIMI
I PRONËS
E APROVUAR

■ PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM LEGALIZIMI?

- Prona juaj regjistrohet ligjërisht në regjistrin e të drejtave pronësore në kadastër.
- Ju do të keni kontroll të plotë mbi pronën tuaj.
- Pronën tuaj mund ta jepni me qira, ta shisni, ta dhuroni apo t'ia lëni trashëgim trashëgimtarëve tuaj.
- Pronën tuaj mund ta shfrytëzoni edhe për ta lënë hipotekë apo për të marr kredi bankare për të nisur apo rritur biznesin, ose edhe për qëllime tjera.

■ SITË APLIKONI?

Aplikimin duhet ta bëni në drejtorinë e urbanizmit në komunën tuaj.

Duhet ta plotësoni formularin e aplikimit për legalizim dhe të bashkëngjitni dokumentet e mëposhtme:

- **Dëshmi se ndërtimi ka përfunduar përpara datës 5 shtator 2018.**
- **Kopje të certifikatës së pronësisë që dëshmon të drejtat tuaja pronësore/poseduese mbi parcelën.**
- **Matjet e ndërtimit (nëse jeni përfitues i ndihmës sociale, komuna do të mbulojë shpenzimet e matjeve).**
- **Deklaratën ku pranoni të gjitha përgjegjësitë për sigurinë e ndërtimit.**



■ CILA ËSHTË KOSTOJA E LEGALIZIMIT?

Taksa e legalizimit është shumë e ulët!

Taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I, e që janë shtëpi deri në 450m², është 1€ për m².

Taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë II, që nuk janë shtëpi, është 2€ për m².



Megjithatë, nuk duhet të paguani fare taksë legalizimi, nëse:

- Shtëpia juaj është ndërtuar me leje dhe/ose financim të qeverisë;
- Shtëpia juaj është rindërtuar gjatë periudhës së pasluftës, për shkak të trazirave sociale ose fuqisë madhore;
- Jeni përfitues i skemës së asistencës sociale dhe mund të tregoni kartelë të vlefshme të ndihmës sociale;
- Ndërtimi i juaj mund të identifikohet në ortofotot zyrtare të vitit 2004.